



Në datën 11 nëntor, u mbajt, pranë Hotel Rogner në Tiranë, konferenca për shtyp mbi paraqitjen e rezultateve të arritura në edicionin 2025 të “fushatës së mbikqyrjes nga ajri”, e organizuar nga Policia e Shtetit shqiptar në bashkëpunimin me Departamentin për Sigurinë Publike të Ministrisë së Brendshme italiane që promovoi, me Guardia di Finanza-n, nismën e bashkëpunimit për të katërmëdhjetin vit radhazi.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shqiptar, Ilir Proda, u pasua nga ajo e Drejtorit të Shërbimit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Policisë (SCIP), Drejtues i Lartë i Policisë së Shtetit, Lorenzo Bucossi, dhe e Gjeneral Brigade, Luigi Vinciguerra, Shef i Repartit III të Operacioneve të Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza-s. Në konferencë morën gjithashtu fjalën edhe Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Marco Alberti. Të pranishëm në këtë veprimtari edhe Eksperti italian për sigurinë, Drejtues i Parë i Policisë së Shtetit, Fulvio Manco, Komandanti i Njësisë së Kufirit Detar të Guardia di Finanza-s në Durrës, Nënkolonel Francesco Della Corte dhe Eksperti i Guardia di Finanza-s, Kolonel Giampiero Carrieri.

Lufta ndaj prodhimit të kanabisit dhe trafikut të lëndëve narkotike është një objektivi i përbashkët i të dy Vendeve, arsye për të cilën Departamenti i Policisë së Shtetit financon veprimtaritë që bashkërendohen nga Drejtoria e Qendrore e Policisë Kriminale nëpërmjet Shërbimit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Policisë (SCIP), në bashkëpunim me Komandën e Përgjithshme të Guardia di Finanza-s dhe me kontributin shkencor të Konsorciumit Benecon.

Gjatë edicionit 2025 të “fushatës së mbikqyrjes nga ajri”, janë identifikuar, çrrënjësuar dhe asgjësuar 106.894 bimë kanabisi dhe është vërtetuar prania e 1003 plantacioneve të paligjshme.

Krahas luftës ndaj trafikut të lëndëve narkotike, misioni italian në ndihmë të policisë shqiptare është i pranishëm në disa fusha duke u bërë kështu një

model i jashtëzakonshëm bashkëpunimi operativ midis forcave të policisë së dy Vendeve çka ka mundësuar arritjen e standarteve gjithmonë e më të larta të sigurisë. Me këtë rast u vu theksi në rëndësinë e luftës ndaj pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme si një faktor kyç për shkatërrimin e organizatave kriminale.

Në fjalën e tij, Ambasadori Marco Alberti falënderoi Policinë e Shtetit italian dhe atë shqiptar si edhe Guardia di Finanza e të gjitha Autoritetet e përfshira në fushatën e mbikqyrjes nga ajri. Rezultatet e arritura, theksoi Ambasadori, janë fryt i një bashkëpunimi të hershëm, i forcuar ndër vite e që priret të forcohet më tej, një faktor i rëndësishëm ky në marrëdhëniet dypalëshe me Shqipërinë. Lufta ndaj çdo forme paligjshmërie është pjesë përbërëse e strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e parimeve dhe vlerave që karakterizojnë Vendin tonë e, në bazë të të cilave, synon të ndërtojë një marrëdhënie gjithmonë e më të ngushtë me Shqipërinë.